Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Naser Fejzullahu	**05.12.2023**	**12.12.2023**	**2023/0977**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 05.12.2023, "NMA Sh.p.k. " ka parashtruar ankesë me Nr: 0997/23 , kundër Njoftim Vendimit mbi dhënien të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Vlerësimi i rrezikut në punë dhe mjedisit të punës me numër të prokurimit TU-23-10363-2-2-1, të iniciuar nga AK – N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A..

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura te hapur, lloji i kontratës: Sherbime, vlera e parashikuar e kontratës: 25,000,00 € vlere e mesme.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë 27.09.2023, data e hapjes së ofertës 19.10.2023, data e Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues 16.11.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 6 i LPP-së Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtimin/Jo – Diskriminues

Neni 52.7 i LPP-se – Njoftimi i kritereve per dhenie te kontrates

Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlersimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 i LPP-së - Kriteret për dhënjen e Kontratës

Neni 69 i LPP-së – Kapaciteti teknik dhe profesional

Neni 72 i LPP-së – Sqarime shtese

Neni 108A i LPP-se – Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Vendimi i PSH te OSHP-se nr.2023/0467

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1.Listë të stafit profesional të certifikuar nga MPMS për Siguri dhe Shëndetin në punë dhe autoriteteve tjera përkatëse dhe atë

- Minimum një (1) Ekspert Inxhinier i Mjedisit
- Minimum një (1) Ekspert të Makinerisë
- Minimum një (1) Ekspert të Elektroteknikes
- Minimum një (1) Ekspert të Fizikë
- Minimum një (1) Ekspert të Kimisë
- Minimum një (1) Ekspert të Biologjisë
- Minimum një (1) Ekspert të Arkitekturës
- Minimum një (1) Ekspert të Ndërtimtarisë
- Minimum një (1) Ekspert të Makinerisë - Komunikacion - • Doktor i mjekësisë së punës i Licencuar nga autoritetet përkatëse.
- Minimum një (1) Ekspert për mbrojtje nga zjarri i certifikuar nga AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës) i profilizuar në shkencat teknike për dhënien e shërbimeve sipas Udhëzimit Administrativ NR.10 2018. Stafi profesional duhet ti përmbush kapacitet bazuar në ndarjen e faktorëve e rrezikut sipas Rregullores 02 2021 , rregullores 01 2021 dhe udhëzimit administrativ (MPB) nr.10 2018 AME për trajnimin fillestar në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe Autoritetet e Ministrisë së mjedisit.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, ne vlere minimale prej 35,500.00 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).

Licencë valide nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për ofrimin e shërbimeve nga Siguria dhe Shëndeti në Punë, komform Rregullores Nr. 01 2021. Licenca për Certifikimin e stafit profesional për SSHP Autorizimi për hartimin e projekteve kundër zjarri nga AME Autorizimi për trajnim për mbrojtje nga zjarri nga AME

Operatori Ekonomik duhet te lëshoj një deklarate qe Oferta e tij është konform kërkesave te specifikacionit teknik Aneksi 1.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Për të gjithë stafin dëshmi - Certifikata nga MPMS dhe kontratat e punës ose marrëveshjet për projektin konkret. 2. Eksperti për mbrojtje nga zjarri duhet te ketë edhe certifikate dhe autorizimin për mbajtjen e trajnimit fillestar për mbrojtje nga zjarri nga AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës). 3. Inxhinieri i mjedisit duhet të jetë i certifikuar nga autoritetet e MMPH për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. 4. Diplomat dhe Certifikatat apo autorizimet e gjithë stafit duhet të jenë të noterizuara nga vet personi përkatësisht bartësi i dokumentit.

Një listë te kontratave të realizuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te shërbimeve.

Kopjen e Licencës – Valide dhe autorizimeve përkatëse nga autoritetet kompetente.

Deklarate e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.

Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët**]

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

OE N.N "Bli Term " Oferon tenderin e pergjegjeshem me cmimin me te volitshem.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Ka interes juridiko material sipas nenit 4.1.26

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" NMA " SH.P.K.**

Përgjigjja ne pretendim ankimor 1

Sa i perkete pretendimit qe eshte shkelur nenin 1 i Ligjit ky nen nuk ka te beje per Ankesa referimi i këtij nenin eshte gabim qe ju keni referuar mirpo ky nen ka te beje per zyrtaret publik te Kosoves qe punojnë neper AK qe ne baze te këtij neni duhet te zgjedhin metodën dhe procedurat me te mire qe ka te beje per aktivitetet e prokurimit qe do ta iniciojnë. Po e citojm nje pjese te nenit :

AK te Kosoves duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Ne kete rast qe OE ankues ju ka referuar nenit 6 eksperti mendon se nuk ka te beje neni 6 vetem cmimimi por edhe kushtet tjera te ligjit, nese do te ishte ne dosjen e tenderit qe te ofertohet vetem cmimi mendoj se Ak nuk I ka respektuar nenin 6 mirpo ketu jane kerkuar edhe kushtet tjera qe ne kete rast une si ekspert po mendoj se OE I ka plotesuar pjesrishe, pasi vetem diploma e Adelina Avdimetaj qe eshte kopje por nuk eshte e notorizuar.

Ndersa sa I perket nenit 7 nuk ka respektuar AK-ja pasi si OE eshte diskriminuar mendoj se eshte vlersuar oferta e OE ankuas por jone ne perputhje me nenin 72 te LPP-se qe mundet te cilsohet se eshte bere nje diskriminim nga AK-ja ketij OE ankues. Eksperti shqyertues mendon se Diploma dhe

Licenca nuk jane te noterizuar ashtu siqe eshte kerkuar ne dosjen e tenderit mirpo dhe ne baze te kesaj pretendimi ankimore eshte pjesrisht I bazuar.

Pretendimi 3 sa I perket se eshte shkelur neni 59 I LPP-se une si ekspert mendoj se ketu nuk ka te beje nenin 59 pasi nuk ka pas paqartesi siqe kerkohet me nenin 59 , ky nen ka te beje kur nuk I ke te qarta specifikimet teknike, ndersa ketu ka te beje lidhur me dokumentet e pa notorizuar qe ka qene kerkese e dosjes se tenderit dhe ka qene e qarte. Eksperti mendon se eshte bere shkelje e nenit 59 pasi nuk eshte bere vlersim professional I ofertave siqe eshte edhe kerkesat e ligjit. Mirpo ne baze te nenit 72 te LPP-se dhe nenit 69 te LPP-se eshte dashur ti kerkohet Licenca dhe Diploma qe te sjelll te noterizuar pasi jane dokumente qe kane te bejne para publikimit njoftimit per kontrate.

AK e duhet ti beje vlerësimin e licencave dhe diplomat ne baze te nenit 59 te LPP-se dhe ne baze te nenit 69 pasi ne dosjen e tenderit është kërkuar licenca dhe diploma te noterizuar dhe ne baze te nenit 69 mundet te kete sqarime . Po e citojm nenin .

Në procedurat që shpien në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkohen lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë.

Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.

OE ankues pretendon se eliminimi është kosntatim i gabuar i AK-së ne e cekur ne kërkesën per rishqyrtim se i posedon te noterizuar Licencën dhe Diplomen por eshte ngarkuar fajlli origjina e nuk eshte ngarkuar failli i noterizimeve qe AK-ja eshte dashur te aprovoj kërkesën per rishqyrtim , bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe se eliminimi i AK-së në këtë pikë është në kundërshtim me kërkesat e ligjit te prokurimit.

Sa I perket pretendimit se eshte shkelur neni 72 I LPP-se Eksperti shqyertues kete pretendim e cileson sit e bazuar pasi dokumente per te cilat eshte eliminuar kompania ankuese I perkasin nenit 69 te LPP-se duke u bazuar ne nenin 72 dhe 69 te LPP-se keto dokumente muned ti kerkoj dokumentet licencen dhe diplomen ti sjell te noterizuara pasi jane dokumente qe jane para

publikimit te njoftimit per kontrate. Kompania ankues I ka dorezuar Diplomen dhe Licencen Adelina Avdimetaj – Doktoor I Mjekesis me oferte por nuk jane te noterizuar siqe ka qene kerkesa e dosjes se tenderit. -Deshmia e DT: 4. Diplomat dhe Certifikatat apo autorizimet e gjithë stafit duhet të jenë të noterizuara nga vet personi përkatësisht bartësi i dokumentit.

Gjithashtu eliminimi I kompanis ankuese eshte edhe ne kundershtim me nenin 64 te LPP-se. Citat I ligjit:

Dëshmitëekërkesave

Njëkandidatosetenderuesdo tëdëshmoj mecertifikatë,vërtetimapodëshmitëtjeratë mjaftueshmetë kërkuaranëmënyrëtëarsyeshmengaAutoritetiKontraktuesqë:(i)arsyet për mos-kualifikimsipasnenit65 tëkëtijligjinukzbatohen;(ii)tëverifikojëpërshtatshmërinëetij profesionale,siçkërkohetnga Autoriteti Kontraktuessipasnenit66tëkëtijligji;(iii)iplotësojnë kriteret ekërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit68-71 tëkëtij ligji.

Kompania ankuese ju ka referuar edhe nje vendimit te OSHP-se nr. 0467/2023 po e citojm paragrafit e vendimit: Paneli Shqyrtues këtë pretendim e klasifikon si pjesërisht të bazuar për shkak se OE këtë kërkesë të DT proceduralisht e kishte përmbushur megjithate edhe obligohet AK që konform nenit 52.7, 59.2 dhe 72 të LPP të kërkojë nga OE sqarime shtesë në fazën e ri-vlerësimit me qëllim që të vërtetohet dhe konfirmohet prezenca e udhëheqësit të punishtes gjatë gjithë kohës së punimeve, meqë kjo pozitë duhet të jetë shumë e nevojshme dhe me prezencë të tij për realizimin e projektit.

Pretendi I OE ankues se eshte shkelur nenin 60 I LPP-se mendoj si ekspert shqyertu se ky pretendim qendron pasi kompania ankuese eshte me cmim me te ulet 12,495.00 € ndersa kompania e rekomanduar per kontrate ka cmim 18,130.00 € .

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar ne sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyertues i propozon panelit shqyertues qe ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar, te anulohet njoftimi
per dhënie te kontratës dhe rekomandon qe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" NMA " SH.P.K.**

Naser Fejzullahu